



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

PROCEDURAT E HETIMIT TË KONKURENCËS

SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA
KONKURRENCA E DREJTË

9



Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju
Kosovo Competition Authority

**SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA
KONKURRENCA E DREJTË (Broshura Nr.9)**

PROCEDURAT E HETIMIT TË KONKURRENCËS

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar)¹ përcakton rregullimin e praktikave të caktuara anti-konkurrese të ndërmarrjeve biznese që eliminojnë ose shtrembërojnë konkurrencën efektive në treg dhe, si rezultat, dëmtojnë mirëqenien e konsumatorit në Kosovë. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ka një sërë kompetencash hetimore, në përputhje me praktikën ndërkombëtare, për të siguruar zbatimin efektiv të Ligjit dhe për të marrë masat e nevojshme kundër shkeljeve të rënda. Në fakt, këto kompetenca janë pjesë e procedurave hetimore të Autoriteteve dhe të cilat shpjegohen në këtë tekst.

Fillimi i një procedure hetimi

Nisja e një procedure nga Autoriteti për hetimin e konkurrencës mund të shfaqet nga disa burime. Së pari, Autoriteti me vet iniciativën e tij mund të fillojë një hetim për marrëveshje të ndaluara (përfshirë kartele të dyshuara) dhe abuzime të dyshuara me një pozitë dominuese në tregun e Kosovës². Në të njëjtën mënyrë, mund të niset një procedurë hetimi në lidhje me përgendrime të caktuara³.

Një burim i dytë janë ankesat. Sipas Ligjit, palët e mëposhtme mund të paraqesin një ankesë ose një kërkesë pranë Autoritetit në lidhje me praktika dhe sjellje të pretenduara anti-konkurrese, duke paraqitur informacionin e specifikuar dhe duke kërkuar veprime nga Autoriteti⁴:

- Një person fizik ose juridik,
- Një shoqatë profesionale ose ekonomike që ka një interes në këtë çështje
- Odat e tregtisë
- Shoqatat e konsumatorëve,
- Qeveria e Republikës së Kosovës

¹ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (Nr. 03 / L-220) i vitit 2010 i ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Nr. 04 / L-226) të vitit 2014..

² Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 35.

³ Shikoni, për shembull, nenin 20 (3) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar)).

⁴ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 34.

▪ Çdo organ i administratës publike, qendrore dhe lokale.

Në vijim të pranimit të një ankese ose kërkesë, Autoriteti, pavarësisht kësaj mund të vendosë, se nuk ka një interes publik për të filluar procedurën e hetimit ose, pas një rishikimi paraprak të tregut përkatës, mund të vendosë që nuk ka asnjë bazë të qëndrueshme për të filluar procedurën e hetimit⁵. Në mënyrë tipike, Autoriteti ka deri në 10 muaj për të refuzuar në këtë mënyrë një ankesë dhe duhet të prezantojë arsye të hollësishme për veprimin e tillë.⁶

Një burim tjetër për nisjen e një procedure hetimi mund të jetë një përqendrim i njoftuar dhe poashtu kur Autoriteti me iniciativën e tij mund të fillojë një hetim në lidhje me një përqendrim i cili dyshohet të jetë zbatuar në mënyrë jo të duhur ose i cili nuk ka një aprovim të kërkuar nga Autoriteti.⁷

Kur Autoriteti vendos të iniciojë një procedurë hetimi, Autoriteti do të specifikojë bazën ligjore sipas Ligjit për ta bërë këtë, vlerësimin e tij paraprak dhe arsyet për hetimin dhe do të lëshojë një kërkesë ose kërkesa për informacion për secilën palë përkatëse.

Në raste jashtëzakonisht urgjente, kur ekziston rreziku për një dëmtim serioz dhe të pariparueshëm të konkurrencës në treg, Autoriteti mund të iniciojë procedurën kundër një ndërmarrje të caktuar dhe të marrë një vendim për *masat e përkohshme*. Në raste të tilla, Autoriteti do t'i kërkojë ndërmarrjes të ndalojë një aktivitet të caktuar bazuar në vendimin për masa të përkohshme dhe të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm për të eliminuar menjëherë efektet e dëmshme në treg dhe shtrembërimin e konkurrencës. Normalisht masa të tilla të përkohshme mund të urdhërohen për një periudhë që nuk i kalon 6 muaj⁸.

⁵ Në këtë situatë, ankuesi ose pala kërkuese ka të drejtën e qasjes në dokumentet mbi të cilat është bazuar vendimi i Autoritetit (neni 44 (6) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar).

⁶ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), neni 35 (5) dhe (7).

⁷ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), neni 35(2).

⁸ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), neni 48.

Hetimi

Autoriteti ia komunikon vendimin për fillimin e një procedure hetimi (në formën e një “konkluzioni” paraprak) palës kundër së cilës ka filluar procedura, ose parashtruesve të kërkesës për një përqendrim të njoftuar. Në veçanti, pala ose palët kundër të cilave ka filluar procedura u kërkohet të paraqesin brenda 30 ditëve (përveç nëse ky afat zgjatet për arsye të justifikueshme nga Autoriteti) komentet e tyre në lidhje me substancën e hetimit së bashku me informacionin dhe dokumentacionin përkatës.

Nëse pala kundër së cilës është filluar procedura dështon t'i përgjigjet kërkesës për komente dhe informacione brenda afatit të specifikuar, Autoritetit i kërkohet të vazhdojë me hetimin në bazë të njohurive të tij, të dhënave dhe dokumentacionit që ka në dispozicion dhe më pas të njoftojë palën kundër së cilës ka filluar procedura për gjetjet paraprake të hetimit⁹.

Për të zhvilluar hetimin e tij, Autoriteti ka të drejtë të kërkojë një sërë informacionesh nga pala kundër së cilës është filluar procedura dhe nga palët e tjera (p.sh. konkurrentët). Në raste të përshtatshme Autoriteti mund të ndërmarrë gjithashtu inspektime të pa-njoftuara (shih më poshtë).

Në lidhje me kërkesat për informacion, Autoriteti është i autorizuar t'u bëjë një kërkesë me shkrim palëve në procedurë (palës kundër së cilës është filluar procedura ose palëve në një përqendrim), si dhe subjekteve të tjera të biznesit, shoqatave të biznesit, dhomave të tregtisë, shoqatave të konsumatorëve, institucioneve shtetërore dhe organeve të qeverisjes lokale. Kërkesa duhet të specifikojë bazën ligjore, rastin në fjalë dhe qëllimin e kërkesës, afatin e zbatimit të saj dhe një paralajmërim për palët në procedurë dhe personat e tjerë fizikë ose juridikë se ata mund t'u nënshtrohen ndëshkimeve sipas ligjit nëse nuk veprojnë në përputhje me kërkesën.

Vetë kërkesa mund të kërkojë nga palët në procedurë të

⁹ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), neni 37.

mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë në të gjitha ambientet e biznesit, pasuritë e paluajtshme dhe sendet e luajtshme, librat e biznesit, bazat e të dhënave dhe në dokumentacione tjera, si dhe të kryejnë veprime tjera që mendohen të nevojshme për të konstatuar të gjitha faktet përkatëse në lidhje me rastin¹⁰. Kjo fazë e mbledhjes së informacionit hetimor ka për qëllim që t'i sigurojë Autoritetit provat e nevojshme për të bërë një vlerësim paraprak nëse ka pasur shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës – sidomos në lidhje me marrëveshjet e ndaluara (përfshirë formimin dhe funksionimin e karteleve), abuzimet me një pozitë dominuese në treg ose një përqendrim të paligjshëm.

Ndërkohë që Autoriteti mund të kryejë inspektime të paracaktuara me palët në lokalet e biznesit në procedurë në përputhje me hyrjen e kërkuar, në rastet e përshtatshme Ligji ia lejon gjithashtu të kryejë inspektime të pa-paralajmëruara (ndonjëherë të referuara në ligjin e konkurrencës si "bastisjet e agimit").

Inspektime të parajmëruara ("bastisjet në agim")

Inspektimet e parajmëruara nuk paraqiten në çdo hetim. Për të kryer një inspektim të tillë, Autoriteti kërkon një urdhër nga Gjykata Themelore për t'i lejuar zyrtarët e Autoritetit të hyjnë, pa njoftim paraprak ose leje të veçantë, në ambientet ose ndonjë pronë tjetër ose vend të ndërmarrjes që përdoret për të kryer veprimtari biznesi, veçanërisht nëse ekziston mundësia për fshehjen ose shkatërrimin e provave.

Zyrtarët e autorizuar të Autoritetit (ndonjëherë të shoqëruar me zyrtarë të autorizuar të policisë), pas prezantimit të autorizimeve të tyre, mund të hyjnë dhe të kryejnë inspektime në të gjitha ambientet e biznesit, depot e hapura dhe mjetet e transportit në ambientet e ndërmarrjeve kundër të cilave po kryhet procedura, si dhe në çdo adresë tjetër ku ajo ndërmarrje operon. Ata mund të kontrollojnë gjithashtu edhe librat e biznesit dhe dokumentet e tjera që lidhen me biznesin e ndërmarrjes, të marrin dhe/ose kopjojnë librat e biznesit dhe dokumente tjera ose fragmente nga

¹⁰ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), neni 38.

librat e biznesit dhe dokumenteve tjera, në formë elektronike ose ndryshe, të bëjnë kopje të dokumenteve të tilla dhe të vendosin një vulë plumbi në libra ose dokumente të caktuara të biznesit gjatë kohës së inspektimit (për shembull, kur inspektimi zgjat disa ditë).

Dokumentet dhe regjistrat e tjerë të biznesit mund të merren përkohësisht nga lokalet e biznesit nga zyrtarë të autorizuar duke i ndërmarrjes që inspektohet një listë të këtyre dokumenteve. Autoriteti mund t'i mbajë regjistrat biznesor të tillë derisa të shqyrtojë të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse në lidhje me këto regjistra ose, më së voni, derisa të merret vendimi përfundimtar për hetimin.

Gjatë një inspektimi të papritur, zyrtarët e autorizuar të Autoritetit mund të kërkojnë nga përfaqësuesit e ndërmarrjes ose punonjësit dhënien e deklaratave verbale në lidhje me faktet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me qëllimin e inspektimit. Ata gjithashtu mund të kërkojnë nga përfaqësuesit e ndërmarrjes ose punonjësit që të paraqesin komente me shkrim në lidhje me faktet ose dokumentet që lidhen me qëllimin e inspektimit dhe të përcaktojnë periudhën e nevojshme kohore për dërgimin e komenteve të tilla. Në përgjithësi, zyrtarët e autorizuar të Autoritetit mund të kryejnë punë tjera të kësajsoj që mund të jenë të nevojshme për të arritur qëllimin e inspektimit¹¹.

Nëse një ndërmarrje refuzon të lejojë zyrtarët e autorizuar të Autoritetit të hyjnë në ambientet e biznesit, nëse pengon inspektimin e librave të biznesit dhe dokumenteve të tjera ose ndërhyjnë në inspektim me ndonjë mënyrë tjetër, zyrtarët e autorizuar të Autoritetit mund, me ndihmën e zyrtarëve të autorizuar të policisë hyjnë në ambientet e biznesit dhe kryejnë inspektimin.

Autoriteti mund të kryejë një inspektim të pa-paralajmëruar edhe kur procedura zyrtare e hetimit nuk ka filluar ende (siç përshkruhet më sipër). Autoriteti mund të inspektojë gjithashtu edhe vendbanimet e anëtarëve të bordit të një ndërmarrjeje ose të

¹¹ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 39.

punonjësve të saj kur ka arsye për të besuar se aty gjinden librat e biznesit ose dokumente tjera që lidhen me një procedurë hetimi¹².

Gjatë inspektimeve të pa-paralajmëruara zbatohen disa masa mbrojtëse të rëndësishme. Këto përfshijnë nevojën për një urdhër të Gjykatës Themelore, të bazuar në një justifikim të mjaftueshëm për inspektimin e prezantuar nga Autoriteti. Masat mbrojtëse shtesë përfshijnë ndalimin e marrjes në pyetje që mund të shkelë të drejtat e personave për të shmangur vetë-inkriminimin (ose të drejtën e personave të tillë për të refuzuar t'u përgjigjen pyetjeve të tilla). Për më tepër, informacioni që sipas ligjit konsiderohet sekret mbrohet gjatë gjithë procedurës së hetimit¹³.

Pas inspektimit të pa-paralajmëruar, zyrtarëve të autorizuar të Autoritetit u kërkohet të përgatisin një raport mbi inspektimin, duke përfshirë detajet e dokumenteve të prokuruar dhe deklaratave të personave të intervistuar gjatë inspektimit. Ky raport kërkohet të përgatitet brenda 15 ditëve dhe t'u ofrohet palëve në procedurë dhe personave që ishin subjekt i inspektimit të pa-paralajmëruar. Brenda 15 ditësh, të gjitha palët e tilla mund të japin komente në lidhje me raportin pranë Autoritetit.

¹² Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 41.

¹³ Shikoni, për shembull, nenet 34, 37, 42, 44, 45, 47, 50 dhe 55 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar).

Njoftimi i fakteve

Pasi të ketë mbledhur dhe shqyrtuar informacionin përkatës në kuadër të hetimit, Autoritetit i kërkohet të sigurojë një njoftim me shkrim në lidhje me faktet paraprake të gjetura në procedurën e hetimit, përpara se të caktojë një seancë dëgjimore për çështjen. Brenda një muaji nga marrja e këtij njoftimi, palët në procedurë kanë të drejtë të japin komentet e tyre, të propozojnë dëgjimin e dëshmitarëve shtesë dhe t'i paraqesin Autoritetit prova shtesë.

Nëse Autoriteti, si rezultat i këtij konsultimi, ndërmerr analiza shtesë të cilat, në një mënyrë ose në një tjetër, gjejnë fakte ose prova të reja që ndryshojnë qartë situatën e paraqitur në njoftimin me shkrim, Autoriteti, pas lëshimit të një njoftimi të ri, mund të të marrë një vendim që ndryshon nga konkluzionet paraprake në njoftimin fillestar. Duke u bazuar në këtë, Autoritetit nuk i lejohet të mbështesë një vendim në lidhje me një hetim mbi fakte dhe rrethana për të cilat palëve në procedurë nuk u është dhënë mundësia të mbrohen.

Qasja në dosjet e hetimit të Autoritetit nga palët në procedurë të hetimit lejohet brenda 15 ditëve, nëse kërkohet me shkrim pasi të jetë pranuar njoftimi i fakteve. Sidoqoftë, informacione dhe dokumente të caktuara do të konsiderohen konfidenciale për Autoritetin dhe nuk do të zbulohen përmes qasjes në shkresat e çështjes. Një informacion i tillë përfshin draft-vendimet, shënimet e brendshme, informacione të mbrojtura në bazë të sekretit të biznesit dhe komunikime me Komisionin Evropian ose autoritetet e huaja të konkurrencës.

Është e rëndësishme të theksohet gjithashtu se një palë në procedurë hetimore mundet, në çdo kohë nga fillimi i procedurës dhe para njoftimit në lidhje me faktet paraprake të gjetura në hetim, të kërkojë nga Autoriteti të pranojë *angazhimet* që pala të ndër marrë masa dhe veprime specifike për të eliminuar efektet negative të aktiviteteve të saj si dhe dështimet e shkaktuara konkurrencës në treg brenda një periudhe kohore të specifikuar. Autoritetit i kërkohet të pranojë angazhime të tilla nëse i sheh këto si të mjaftueshme për të eliminuar efektet negative dhe për të

siguruar rivendosjen e një konkurrence efektive. Kur kjo të ndodhë, zotimet e propozuara bëhen të detyrueshme për ndërmarrjen ose ndërmarrjet në fjalë dhe vihet në funksion një mekanizëm monitorimi dhe hetimi përfundon.

Seancat dëgjimore orale

Duke lejuar komente mbi gjetjet paraprake të hetimit dhe në mungesë të angazhimeve specifike nga pala ose palët në procedurë, hapi tjetër është zakonisht një seancë dëgjimore orale për të diskutuar çështjen me palët e interesuara dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë. Këto dëgjime nuk janë publike për shkak të diskutimit të mundshëm të sekreteve të biznesit të mbrojtura me ligj. Dëshmitarët, përfshirë personat ose organizatat ankuese fillestare, mund të ftohen të paraqiten para seancës. Nëse palët e ftuara nuk paraqiten para dy seancave të caktuara në mënyrë të rregullt, Autoriteti mund të procedojë me përfundimin e hetimit duke u bazuar në informacionin në dispozicion të tij¹⁴.

Vendimi i Autoritetit

Autoriteti i kërkohet të marrë një vendim pas hetimit të tij brenda 90 ditëve nga gjetja e fakteve përkatëse në lidhje me marrëveshjet e ndaluara ose abuzimet me një pozitë dominuese në treg. Vendimet në lidhje me përqendrimet e hetuara duhet të finalizohen nga Autoriteti brenda 90 ditëve nga fillimi i hetimit. Afatet e tjera zbatohen për rrethana specifike të tilla si ndalimi i përjashtimeve në bllok (grup) të marrëveshjeve të caktuara, anulimi i një përqendrimi të miratuar etj. Përjashtimisht, Autoriteti mund të zgjasë afatet e kërkuara për nxjerrje të vendimit deri në 60 ditë¹⁵.

¹⁴ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 47..

¹⁵ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 53. Shumëllojshmëria e llojeve të vendimeve që Autoriteti mund të marrë përcaktohet në Nenin 54 të Ligjit..

Vendimi i Autoritetit mund të jetë pozitiv, negativ ose kushtëzues dhe mund të përfshijë vendosjen e gjobave për shkelje të vërtetuara të Ligjit. Autoritetit i kërkohet t'u sigurojë palëve në procedurë një kopje të vendimit të tij jo më vonë se 30 ditë nga dita e skadimit të afatit marrjen e vendimit dhe për ta botuar atë në Gazetën Zyrtare dhe në faqen e internetit të Autoritetit. Kur procedura ka filluar bazuar në një ankesë ose kërkesë për një hetim, këto palë iniciuese gjithashtu duhet të marrin vendimin. Vendimet e publikuara duhet të përjashtojnë sekretet biznesore të mbrojtura me ligj.

Vendimet e Autoritetit mund të apelojnë në Gjykatën Administrative të Prishtinës. Në një rast të tillë, vendimi i Gjykatës duhet të publikohet gjithashtu në faqen e internetit të Autoritetit.

nformata të mëtejshme

Për informacione të mëtejshme, shihni broshurat e tjera në serinë e broshurave të AKK-së “***Sigurimi i përfitimeve nga Konkurrenca e Drejtë***” dhe vizitoni faqen tonë të internetit në: <https://ak.rks-gov.net/>



Funded by
the European Union



Kjo broshurë është përgatitur me ndihmën e Projektit të financuar nga BE: "Mbështetje e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore" menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe zbatuar nga një Konsorcium I B&S Europe

